

Afishim Publik

Rehabilitimi i Shëtitores “Taulantia”, Segmenti Nga Pista Tek Sheshi “Sfinksi”

Gjithashtu pjese e vazhimit të vizionit dhe strategjisë së Bashkisë Durrës për zhvillimin urban dhe infrastrukturor të qytetit është edhe projekti i Rehabilitimit të Shëtitores “Taulantia”, Segmenti nga Pista tek Sheshi “Sfinksi”.

Nëpërmjet këtij projekti synohet rehabilitimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i këtij segmenti, dhe transformimi i kësaj promenade duke shkruar dizajnin arkitekturor me natyrën e bukur që ofron bregdeti i Adriatikut.

Koncepti kryesor është që përgjatë promenadës të krijohet një hapësirë panoramike, gjithashtu rekreative dhe sociale për vizitorët, duke përdorur mobilimin urban, ndërtimin e një pergolate.

Qëllimi është krijimi i një pike atraktive që do të kthehet në destinacion kryesor në këtë zonë.

Projekti për rehabilitimin e shëtitores Taulantia, segmenti nga pista tek sheshi “Sfinksi” do të ndërtohet duke u bazuar mbi tre objektiva kryesore:

1. Ripërcaktimi i raportit të kësaj zone me zonat urbane pranë saj, me qendrën dhe me elementët e rëndësishëm historike, si objektiv kryesor për të shtuar dhe pasuruar sistemin e hapësirave publike;
2. Ripërcaktimi i raportit të qytetit me fashen bregdetare;
3. Mobilim urban i përshtatshëm me zonën dhe investimet e tjera.